



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:073990

Datë: 13.12.2019

Numri i dokumentit: 00766958

P.nr.99/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren Fitore Daci si dhe praktikanten Laura Hasani në çështjen penale kundër të pandehurit SH.S nga fshati, Komuna Shtime, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës: PP/II.nr.120-9/19 dt.24.01.2019, të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 13.12.2019, në praninë e Prokurorit të Shtetit Albana Parduzi, si dhe të pandehurit SH.S, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

SH.S i lindur me, nga i ati L.....dhe nëna Z.... e gjinisë B....me vendbanim në fshatin, Komuna Shtime, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i pamartuar, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me dt.24.10.2018, rreth orës 15:20, në rrugën, “.....”, në shtime saktësisht në kafeterinë “.....”, Njësiti i Stacionit Policor në Shtime, gjatë një plani operativ “Stop drogave në shkolla” ka identifikuar dhe ndaluar të pandehurin dhe gjatë kontrollimit fizik i kanë gjetur një qese me

substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë prej 1.6gram këtë substancë narkotike e ka poseduar pa autorizim, me c'rast i konfiskohet përkohësisht nga policia.

me këtë ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,41,42,46,49,50,51,52,73 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 300 Euro /treqind euro/, të cilin dënim duhet ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, dhe

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej veprë të re penale.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin brenda afatit prej 1 (një) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ (njëzetë euro), të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.

Konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë prej 1.6gram.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzet euro / në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit.

Detyrohet i pandehuri që në emër të fondit për kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.120-9/19 dt.24.01.2019 ka ngarkuar të pandehurin SH.S, për veprën penale përdorimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të i shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.12.2019 në të cilën shqyrtim gjyqësor: i pandehuri e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza, dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë vepër penale, dhe ndihet thellë i penduar për veprën e kryer, deklaron se nuk do të përdorë më këtë substancë, i premtton gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë ndonjë vepër penale pasi që e ka kryer njëherë dënimin për një vepër të ngjashme dhe tani është i penduar për këto vepra, dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një dënim më të butë.

Prokurorja e Shtetit Albana Parduçi duke shprehur mendimin e saj përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënimin e merituar.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore.

Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e

nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale përdorimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së .

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i pandehuri në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Konform nenit 275 par.3 të KPRK-së, konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë prej 1.6gram.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEPARTAMENTI PERGJITHSHEM-DIVIZIONI PENAL,

P.nr.99/19 datë 13.12.2019

**Praktikantja
Laura Hasani**

**Gjyqtarja
Fitore Daci**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.